

## Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale

### Grupi punues IV: *Avokimi i Iniciativës për KOMRA-në*

17. Tetor 2010.  
Zagreb, Kroaci

Fjalën hyrëse dhe moderimin e bënë Lazar Stojanović (Fondi për të Drejtën Humanitare, Beograd, Serbi), Dinko Gruhonjić (Shoqata e pavarur e gazetarëve në Vojvodinë, Novi Sad, Serbi) dhe Gordan Bosanac (Qendra për studime të paqes, Zagreb, Kroaci). Në grupin punues morën pjesë 40 pjesëmarrës/e dhe dy vëzhgues: Jonathan Sisson (Swisspeace, Zvicërr), dhe Admir Duran (Impunity Watch, Serbi).

#### **Shqyrtimi i propozimeve, rekomandimeve dhe opinionet e pjesëmarrësve/eve:**

#### **Qytetarët duhet njoftuar me idetë e Iniciativës për KOMRA-në.**

*Siç tha zotëri Lazar, në një moment keni thënë së nuk është aq me rëndësi sa është që qytetarët të dinë, se grupet konkrete të synimit janë më të rëndësishmet. Unë nuk pajtohem me këtë sepse mund të vijmë deri të një situatë që ky tregim i ynë të ndodhë, pra që komisioni të krijohet dhe ta prodhojë raportin përfundimtarë, por të mos ketë efektin të cilin ne duam ta arrijmë me këtë rrëfim dhe me këtë përpjekje..* (Milan Cakić, Këshilli për iniciativën qytetare, Nish, Serbi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 17. Tetor 2010.)

*Mendoj se është e nevojshme që paraprakisht të hartohet mirë dhe të shpjegohet pse janë të nevojshëm një milion nënshkrime. Çfarë është rëndësia e kësaj, në mënyrë që secili që i mbledh nënshkrimet dhe i cili do të jetë i ekspozuar në rrugë me poshtërime të ndryshme dhe me momente të shumta demotivuese, në çdo moment për veten duke e ditur pse po e bënë këtë, sepse vetëm në këtë mënyrë mund të komunikohet me tjerët.* (Marina Škrabalo, Qendra për studime të paqes, Zagreb, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 17. Tetor 2010.)

*Mendoj se duhet ta shfrytëzojmë këtë fushatë, që ti përgatisim aktivistët dhe fokusi të mos jetë vetëm në sigurimin e mbështetjes simbolike prej një milion nënshkrimesh, por ti fitojmë së paku një milion përkrahës të cilët do t'ua përcjellin tjerëve idetë për të cilat ne po angazhohemi.* (Zlatko Vujović, CEMI, Podgoricë, Mali i Zi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 17. Tetor 2010.)

**Duhet dalluar fushatën për opinionin publik nga fushata për vendim-marrësit. Fushata duhet të jetë agresive. Në fushatë duket pasur kujdes në planifikimin strategjik, sepse ajo do të zhvillohet në shtatë shtete.**

**Në avokimin publik i drejtohe mi vendim-marrësve, gjegjësisht politikanëve dhe kur flasim për ato porosi, ato sërish formulohen më ndryshe kur paraqiteni para politikës, e ndryshe kur paraqiteni para opinionit publik..** (Marko Veličković, Qendra për zhvillimin e resurseve civile, Nish, Serbi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 17. Tetor 2010.)

**Sa i përket fushatës (...) Duhet të jetë më agresive, tani këtu po e jap një sugjerim. Shumë më agresive, por jo në kuptimin që të shkohet me armë nëpër rrugë dhe të detyrohen njerëzit të nënshkruajnë, por përkundrazi – më agresive në qasje ndaj shërbimeve publike dhe me përmbajtje e cila nuk do të ketë ofendime të ndjenjave të viktimave, familjeve të viktimave dhe të të gjithë qytetarëve tjerë. E dyta, sa më shumë që i afrohesha radhës për të marrë fjalën, aq më rrallë kolegët e mi i përmendnin të rinjtë. Mendoj se në vetë iniciativën janë të rinjtë, posaçërisht ata të shkollave të mesme kanë humbur nga vetë rreth-pamja.** (Tomislav Dujmović, Qendra për studimet e paqes, Zagreb, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 17. Tetor 2010.)

**Duke menduar për të gjithë këto propozime, se çfarë do të duhej bërë, mua mu kujtua se ne duhet, sipas mendimit tim personal pasi që marrëdhëniet ndër-etnike janë një problem shumë të madh, madje edhe shokante, që fushata e KOMRA-së do të duhej të jetë shokuuese. Ndoshta në atë veprim si në Kroaci, nuk di për vendet tjera, kur është punuar promovimi për sigurinë në komunikacion, me ç'rast të gjithë kemi paraqitur fotografi shokuuese, pasojat shokuuese se çfarë u ka ndodhë njerëzve kur nuk i kanë respektuar rregullat në komunikacion (...) Prandaj mu kujtua se ne spotin e promovimit të KOMRA-së ndoshta ndonjë çetnik do të duhej t'i thërrasë Kroatët që të ballafaqohen me të kaluarën, dhe pastaj të na reagojë i tërë opinioni në Kroaci, që të ngritën shoqatat, dhe pastaj ne t'ua sqarojmë se çfarë është KOMRA.** (Srđan Antić, Qendra për Dialog – Nansen, Osijek, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 17. Tetor 2010.)

**Organizata jonë, në Ditën Ndërkombëtare të personave të zhdukur, me 30. gusht, ka organizuar një aksion simbolik, ashtu që ka vendosur 400 palë këpucë në sheshin kryesorë në Prishtinë, atëherë ka pasë shumë njerëz të cilët janë ndalur, të cilët kanë dashtë të nënshkruajnë petitionin për shkak të simbolikës që e kanë parë. Ajo ngjarje ka qenë shumë prekëse, aq emocionuese, saqë nuk ka pasë nevojë që të kërkohet nga ata njerëz që të ndalen dhe të bisedojnë me neve, ata vetë e kanë bërë këtë. (...) Kjo është njëra prej mënyrave, që do të duhej marrë parasysh, kur do ta planifikojmë fushatën e nënshkrimeve dhe diçka që ndoshta do të duhej përfshirë në fushatën mediale të cilën do ta bëjmë.** (Raba Gjoshi, Iniciativa e të rinjve për të drejtat e njeriut në Kosovë, Prishtinë, Kosovë, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 17. Tetor 2010.)

**Ajo çka kemi harruar fare, është se ne këtu i kemi shtatë tregje të ndryshme. Shtatë tregje të ndryshme të cilat pastaj mund ti ndajmë në segmente, siç thonë ata në gjuhën komerciale, në x, y grupe të synimit. Në këtë gjë nuk po kushtohet vëmendje, por kjo rrjedh nga të gjitha diskutimet këtu. Ky nga Osijeku do ta thotë një gjë. Sllovenia do të thotë diç tjetër, Kosova sërish diçka tjetër, edhe në këto duhet kushtuar vëmendje. Prandaj, se në hapat në vazhdim duhet kushtuar vëmendje në planifikimin strategjik të fushatës.** (Tin Nuić, Media Risol, Zagreb, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 17. Tetor 2010.)

## Grup i rëndësishëm i synimit janë të rinjtë.

*Shumë më e thjeshtë është të shkohet në fakultete, prandaj i propozoj fakultetet, dhe gjithashtu pajtohem se fushata do të mund të ishte, nuk do të thoja agresive, por më provokuese. Të provokojë reagime.* (Mladena Tadej, Documenta, Zagreb, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 17. Tetor 2010.)

*Më duket se ndoshta në fazën e parë të lobimit do të ishte shumë më e dobishme t'u qasemi politikanëve të gjeneratave të reja të cilët ndoshta akoma nuk kanë ndikim në publik, por janë më me ndikim dhe të cilët kanë arritur një respekt në partitë e tyre dhe mund ti qasen bartësve kryesorë të politikanëve në mënyrën në të cilën ne nuk do të mundemi.* (Mladena Tadej, Documenta, Zagreb, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 17. Tetor 2010.)

*(...) mendoj se është e domosdoshme që rrëfimin për krimet e luftës ta formësojmë, paraqesim te njerëzit e rinj përmes elementeve të kulturës të popullarizuar.* (Danilo Marunović, drejtor, Podgoricë, Mali i Zi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 17. Tetor 2010.)

*Të punohen dy spote (klipe). Njëri spot të jetë i drejtuar për të rinjtë. Sot, të rinjtë nuk duan të dëgjojnë për krimet. Lufta ka mbaruar para 15 vitesh, dhe nuk mundeni ti mblidhni që ti shikojnë ato. Ata kanë qëndrime më ndryshe dhe pikëvështrime tjera, ndërsa ata janë pjesa më e madhe e popullatës së synimit dhe më e rëndësishme të cilës i drejtohet KOMRA. (...) Ajo që dua të propozoj shtesë, e që është shumë e lirë dhe e mundshme të realizohet, është festivali i filmit të shkurtë i cili do ta mbulojë KOMRA-në. Kjo nuk do të jetë e kushtueshme për KOMRA-në. Këtë do ta bëjnë vetë njerëzit. Jepjani kushtet, jepjani qëllimin, ata do ta bëjnë. Pastaj, galeria e fotografive të artistëve të cilët do ta përshkojnë tërë këtë hapësirë.* (Radomir Jagodić, OJQ Izbjeglica, Rudo, BeH, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 17. Tetor 2010.)

*(...) ne duhet ta kemi parasysh se si detyrë prioritare para nesh po paraqitet një publik i ri, tërësisht i humbur, i pa-arsimuar, pa frymëzuar dhe i pa motivuar. Ata janë shumicë. Shumica prej tyre janë të rinjtë të cilët nuk dinë asgjë, të cilët nuk e lexojnë shtypin, të cilët nuk kanë ndonjë vizion, të cilët fare kanë harruar se çfarë ka ndodhur në Vukovarë.* (Drago Pilsel, gazetarë i pavarur, Zagreb, kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 17. Tetor 2010.)

## Duhet bërë hulumtime të opinionit të publikut lidhur me KOMRA-në

*(...) hulumtimi i opinionit të gjerë mund të jetë shumë i rëndësishëm. Mund të jetë një mekanizëm i fortë i presionit sepse në atë hulumtim mund të kërkonte përgjigjen ne pyetjen e cila mund të sjellë rezultatet të cilat për ju janë shumë të favorshme dhe ato ti paraqitni si lajm i cili do të mund të jetë më i rëndësishëm se sa mbledhja e një milion nënshkrimeve. Pra, nëse ju në secilin shtet të ish Jugosllavisë i keni 40% të njerëzve të cilët thonë se është e nevojshme të emërohet secili shtet, secili krim, pavarësisht se a do të jetë ajo komisioni, ju do ta krijoni atmosferën të cilën politikanet do ta identifikojnë si presion të publikut.* (Marko Veličković,

Qendra për zhvillim të resurseve civile, Nish, Serbi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 17. Tetor 2010.)

**Unë plotësisht e mbështesë idenë e zhvillimit të hulumtimit [të opinionit të publikut], mendoj se kjo është shumë e rëndësishme. Së pari nga aspekti që të shohim se si perceptohet Koalicioni për KOMRA-në në tërë rajonin, dhe mendoj se ky hulumtim nuk do të jetë shumë i kushtueshëm, dhe mund të kërkohej një kompani hulumtuuese publike e përgjegjëse e cila do ta kryente këtë punë për pak para. Dhe e dyta t'i shfrytëzojmë këto të dhëna të cilat janë mbledhë në Kroaci lidhur me nevojën e ballafaqimit me të kaluarën, dhe do të ishte shumë mirë që kjo të bëhet edhe në vendet tjera, sepse kjo e dhënë mund të shfrytëzohet si argument në negociata me ata që janë vendim-marrës. Sepse, nëse ju thoni se 70% e popullatës në Kroaci dëshiron të ballafaqohet me të kaluarën dhe nëse i merrni qëndrimet e njëjta edhe në shtetet tjera të rajonit, atëherë me të vërtetë do të keni në duar një argument të fortë në negociata me ata të cilët marrin vendime.** (Borka Rudić, BeH gazetarë, Sarajevë, BeH, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 17. Tetor 2010.)

**Ne [Misioni i OSBE në Serbi] planifikojmë të bëjmë kësi lloj hulumtimi [të opinionit të publikut lidhur me çështjen e drejtësisë tranzicionale] sërish në një periudhë në të ardhmen. Disa organizata jo-qeveritare, disa përfaqësues të tyre janë prezent këtu në forum, planifikojnë në të ardhmen e afërt të bëjnë një hulumtim të ngjashëm. Pra, ajo që do të duhej bërë, që do të ishte propozimi im, është që këto dy gjëra të ndërliken.** (Jelena Stevančević. Misioni i OSBE në Serbi, Beograd, Serbi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 17. Tetor 2010.)

### **Fushatën për KOMRA-në më së shumti duhet promovuar në televizion.**

**(...) kam frikë se interneti akoma nuk shfrytëzohet në masë aq të madhe në pjesën më të madhe të popullatës. Do të thotë, nëse i heqim qytetet kryesore dhe një grup-moshë të caktuar, kjo mbetet akoma e dobët dhe e paktë, kështu që megjithatë unë do të dëshiroja që televizioni të jetë edhe më tutje njëra prej mënyrave më të rëndësishme të promovimit.** (Nataša Govedarica, Heartefact Fund, Beograd, Serbi, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 17. Tetor 2010.)

**Nëse duam të kemi një fushatë e cila do të shikohet duhet të bëjmë një spot (klip) të mirë, më kualitativ, të qartë dhe duhet të paraqitet në televizionet publike (...) duhet të punohet me qytetarët, për këtë arsye na duhen një milion nënshkrime. Unë jam shumë i sigurt së kurrfarë fushate televizive e as pano, as gjinglet, as interneti, e as facebook-u, as twitter, e as të gjitha hapësirat mediale të cilat do të mund ti kemi në dispozicion në kuptimin e ngushtë të PR-së (...) nuk ka asgjë më kuptimplotë në fushatën e drejtë njerëzore pa qytetarë dhe pa arritur që t'i kemi qytetarët në anën tonë.** (Suzana Kunac, B.a.B.e, Zagreb, Kroaci, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 17. Tetor 2010.)

**(...) e mbështes fuqimisht këtë ide lidhur me shërbimet publike, sepse hulumtimet tona në Bosnjë e Hercegovinë kanë treguar se shumica e popullatës, madje rreth 90% të njerëzve në disa hapësira e shikojnë televizionin publik si burim të vetëm të informimit (...) Pse unë po mendoj se**

janë të rëndësishëm emetuesit publik? Sepse, fatkeqësisht politikanët tonë janë ngushtë të lidhur me emetuesit publik. Redaktorët i duan politikanët tanë dhe anasjelltas, kështu që edhe kjo është një lloj simbioze e cila do të mund të përdoret për ndikim më të fuqishëm në publik. (Borka Rudić, BH gazetarë, Sarajevë, BeH, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 17. Tetor 2010.)

(...) diçka që do të ishte shumë e mirë dhe që do të hapte diskutim të popullata është **përgatitja e një dokumentari i cili do të ofrojë më shumë informata lidhur me fushatën**, më shumë të dhëna për te dhe ai dokumentarë do të mund tua sqaronte njerëzve të cilët nuk kanë qenë pjesë e konsultimeve, se çfarë në fakt punon Iniciativa dhe çfarë dëshiron të arrijë. Duke marrë parasysh se spotet (klipet) të cilët janë punuar dhe emituar në televizione dhe në media tjera, janë porosi mjaft të shkurtra të cilat nuk kanë qenë shumë të qarta dhe nuk janë kuptuar qartë në publik, prandaj vlerësoj se duhet të punohet një dokumentarë dhe ti jepet hapësirë e mjaftueshme atij dokumentari i cili do të paraqitet disa herë në televizionet nacionale dhe lokale. (Raba Gjoshi, Iniciativa e të rinjve për të drejtat e njeriut në Kosovë, Prishtinë, Kosovë, Forumi i shtatë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 17. Tetor 2010.)